



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT - RREGULLORES SË RE TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Projekt – Rregullores së re të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës, Kryesues,
2. Armend Grajqevci, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK
3. Elmaze Behluli , anëtare e kuvendit nga subjekti politik LDK
4. Argjnt Tasholli, anëtar i kuvendit nga subjekti politik PDK
5. Shahadije Dragaçina, anëtare e kuvendit nga subjekti politik LVV
6. Vlora Krasniqi , Udhëheqëse e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
7. Behar Aliu , Zyrtar Ligjor, Sektori për punë të Kuvendit dhe të komiteteve , anëtar

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë të bëjë hartimin e Projekt –Rregullores së re të Kuvendit të Komunës së Lipjanit , duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu brenda afatit 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-13722
Lipjan, më 24.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi